

VENDIM
Nr. 477, datë 31.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 463, DATË 22.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK NË KOPLIK,
MALËSI E MADHE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 463, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Lista e pasurive, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me listën me të njëjtin titull që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Në pikën 9, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK”, KOPLIK, MALËSI E MADHE

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Statusi i pronësisë
1	2220	201/8	arë	985	shtet
2	2220	193	arë	24,823	shtet
3	2220	194	arë	20,878	shtet
4	2220	163	arë	32,801	shtet
5	2220	160	arë	63,747	shtet
6	2220	159	arë	23,942	shtet
7	2220	200	arë	86,417	shtet
8	2220	195/1	kullotë	43,392	shtet
9	2220	157	arë	20,969	shtet
10	2220	158/1	arë	21,397	shtet
11	2220	187/2	arë	55,941	shtet
12	2220	185/4	kullotë	88,552	shtet
13	2220	192	arë	22,000	shtet
14	2221	388	kullotë	73,627	shtet
15	2221	387	kullotë	30,568	shtet
				610039	SHUMA

HARTA E “ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”
KOPLIK, MALËSI E MADHE, SIPËRFAQJA 61 ha

